

THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIMIT PËR TRAJNIM DHE PUNËSIM NË SHËRBIMET E KUJDESIT

Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA, fton të gjithë të interesuarit (në moshë pune) nga Komuna e Prishtinës, të lajmërohen për pjesëmarrje në programin e trajnimit “*Shërbimet e Kujdesit dhe Mirëqenies së Komunitetit*” (kujdes ndaj fëmijëve, kujdes ndaj të moshuarve, mirëmbajtje, etj). Më pas, ky trajnim më pas mund të rezultojë në punësim formal përmes këtij programi.

Qëllimi i këtij programi është përgatitja për punësim dhe ripunësim e të gjithë të interesuarve në moshë pune, me theks të veçantë për gratë në moshë të ndryshme.

Kriteret për pjesëmarrje:

- Të kenë të përfunduar së paku shkollën e mesme,
- Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të gëzojnë shëndet të mirë
- Të kenë fleksibilitet me kohën që të kenë mundësi të ndjekin trajnimin
- Te kenë dëshirë për të punuar me grupet në nevojë (fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, etj).

Të interesuarit duhet ta dërgojnë CV-në më së largu deri me **30. 05. 2017** në adresën e email-it wsheera@gmail.com ose të na kontaktojnë në këta numra: **0390 323 194** dhe **044 307 847**.

Ky program implementohet nga SHE-ERA në bashkëpunim me projektin Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) që implementohet nga Swisscontact në partneritet me Institutin Riinvest dhe PEM Consult dhe financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë.